

**Raport i Ekspertit Kontabël të Autorizuar**  
**Mbi Auditimin ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara**  
**nga Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar**

Në zbatim të Ligjit Nr. 10.019 dt. 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë" dhe Udhëzimit të K.Q.Z-së Nr.8 dt.25/03/2009 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar, për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, për fushatën zgjedhore", me vendimin Nr. 605 dt. 14/9/2009 "Për shpalljen e rezultatit të shortit, për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, për fushatën zgjedhore", jam emëruar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara, për fushatën zgjedhore të Partisë Bashkimi Demokrat Shqiptar.

Me shkresën Nr. 4110 dt. 16/9/2009 jam njoftuar për rezultatin e shortit , të datës 14/9/2009, dhe brënda datës 18/9/2009, pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, kam lidhur kontratën e shërbimit.

Sipas objektit të kontratës, kërkohet kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara, nga Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, për fushatën zgjedhore, në përputhje me Ligjin Nr. 10.019 dt. 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë", Ligjin Nr. 10.091 dt. 05/3/2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar" dhe Ligjit Nr. 9.228 dt. 29/4/2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe akteve nënligjore, të nxjerra me bazë dhe për zbatimin e tyre.

Në bazë të kontratës, të hartuar me K.Q.Z, hartova kalendarin e punës- ku përcaktova planin e punës, duke u mbështetur në Ligjin Nr. 10.019 dt. 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë", nenet 89-90.

***Të dhëna për Partinë Bashkimi Demokrat Shqiptar***

Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, me adresë :

Rruga "Mine Peza"-Ish Komiteti Shkencave dhe Teknikës Tiranë  
Kryetari I Partisë Z. Ylber Valteri  
Financier Z. Sabri Hoti

Për zgjedhjet e datës 28 qershor 2009 Partia Bashkimi Demokrat, pranë Komisionit Qëndror, ka paraqitur listat shumë emrore të kandidatëve për deputetë, për të gjitha zonat zgjedhore; kjo bazuar në nenin 67, pika 2, pika 4 dhe 5 dhe nenin 72, pika 2, germa 'a', të Ligjit Nr. 10.019 dt. 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë".

Për efekt të kontrollit të shpenzimeve nga Kryetari, Z.Ylber Valteri, sigurova listën e kandidatëve për deputet, të Partisë Bashkimi Demokrat Shqiptar, në zgjedhjet e 28 qershorit, të cilat kryesojnë listën sipas qarqeve :

- |                       |                        |
|-----------------------|------------------------|
| 1. Qarku Kukës        | Sokol Beslim Ukperaj   |
| 2. Qarku Shkodër      | Armand Ferit Uruçi     |
| 3. Qarku Dibër        | Ylber Shefki Valteri   |
| 4. Qarku Lezhë        | Ernest Ndue Marku      |
| 5. Qarku Tiranë       | Adrian Reshat Karapici |
| 6. Qarku Durrës       | Ismet Jonuz Mehmeti    |
| 7. Qarku Elbasan      | Niko Gori Sinani       |
| 8. Qarku Fier         | Ylber Shefki Valteri   |
| 9. Qarku Berat        | Liljana Gjysho Karaja  |
| 10. Qarku Vlorë       | Vladimir Tare Fejzo    |
| 11. Qarku Korçë       | Ylber Shefki Valteri   |
| 12. Qarku Gjirokastrë | Ylber Shefki Valteri   |

### ***Kontrolli i regjistrimit të posaçëm dhe Deklaratave të Dhuruesve- Fonde jo publike***

U kontrollua, pranë Subjektit Politik, Vendimi I Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve nr, 266 dt. 01/6/2009 "Për miratimin e modelit të regjistrimit të posaçëm që duhet të përdorin Subjektet Politike për regjistrimin e fondeve të përfituara, për fushatën zgjedhore, si dhe modelin e deklaratës që duhet të nënshkruajnë dhuruesit në çastin e dhurimit" dhe rezultoi se :

Tabela e fondeve të përfituara, nga Partia e Bashkimit Demokrat Shqiptar, prej personave fizikë, ose juridike, vendas, për zgjedhjet në Kuvendin e vitit 2009, është zero ( 0 ). Për këtë shif tabelën bashkangjitur raportit, të plotësuar e nënshkruar nga Kryetari i Partisë Bashkimi Demokrat Shqiptar, Z. Ylber Valteri.

Nuk ka asnjë rast të plotësimit të deklaratës "Mbi konfliktin e interesave për financimin e subjekteve zgjedhore", pasi nuk ka përfituar asnjë kandidat ( shif deklaratën bashkangjitur ).

U kontrollua numri i llogarisë bankare Nr. 4792/7816, me adresë Banka Kombëtare Tregëtare Tiranë, Bulevardi "Zhan D`Ark", i datës 25 shtator 2009, dhe nga data 1 janar 2009 deri 25 shtator 2009 balanca është : Debit zero ( 0 ), Kredit zero ( 0 ).

### ***Kontrolli i fondeve publike për subjektet zgjedhore***

Subjekti Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar nuk ka përfituar asnjë fond , për zgjedhjet e vitit 2009, nga fondet publike, pasi as nuk kanë mandate në Kuvend, as në zgjedhjet pararendëse nuk kanë marrë jo më pak se 2 ( dy ) vende në Kuvend.

### ***Shpenzimet e fushatës zgjedhore të vëna në dispozicion , nga Subjektet Zgjedhore, për Zgjedhjet Parlamentare të datës 28 Qershor 2009***

Nga subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, për Zgjedhjet Parlamentare të datës 28 qershor 2009, na u paraqit një evidencë shpenzimesh, ku regjistroheshin shpenzime të tilla :

#### **I. Kandidati që kryeson listën për Qarkun e Tiranës :**

##### 1. Adrian Karapici

a. Postera	lekë	25.000
b. Karta orjentuese	"	8.000

**Shuma :** " **33.000**

#### **II. Kandidati që kryeson listën për Qarkun e Dibrës :**

##### 1. Ylber Valteri

a. Qera zyre	1 muaj x 15.000 =	15.000 lekë
b. Postera " Si votohet"	copë 5.000 x 1.8 =	9.000 "

**Shuma :** **24.000 "**

Shpenzime me koalicionin "Poli i Lirisë" :

1.Flamuj Partie	copë	15 x 700 = 10.500 lekë
2.Flamuj kombëtar	"	10 x 400 = 4.000 "
3.Pankarta të ndryshme	"	40 x 80 = 3.200 "
4.Letër format A4	"	2 x 500 = 1.000
<b>Shuma :</b>		<b>18.700 lekë</b>

Financimet e mësipërme, gjithsejt, **janë 75.700 lekë** dhe janë përballuar nga vetë kandidatët, që kryesojnë listat në qarqet Tiranë dhe Dibër.

Bashkangjitur pasqyrën e evidencës së shpenzimeve.

**Rezultati i zgjedhjeve :**

Partia Bashkimi Demokrat I Shqipërisë, sipas K.Q.Z-së, është 1.030 vetë, ose 0.07% , koalicioni "Poli I Lirisë" 27.655 vota, ose 1.82%, ku Partia Bashkimi Demokrat është në koalicion.

**EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR  
NAMIK VEIPI**

Vlore, me 02/11/2009